

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË, Divizioni penal, më gjyqtarin Lulzim Paçarizi, si dhe më sekretaren juridike Behije Karaçica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit, N. G., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, ndërsa sipas aktakuzës PP.nr.1821/2017 të dt.22.12.2017, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, ku prezent ishin Prokurori e shtetit Bajram Kryeziu dhe i akuzuari N. G., e gjykata më dt.21.03.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: N. G., nga i ati H. dhe e ëma Sh. e lindjes K., i lindur më datën ..., në fshatin V., komuna e Malishevës, ku edhe jeton, më nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, i ati i 5 fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak së në mes të datës së pavërtetuar e gjerë më dt.09.06.2017, në fsh. V. K. Malishevë, në shtëpinë e tij, më qëllim vetit apo tjetrit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm me qëllim vjedhje, pa njëjsor elektrik përmes kabllor është lidhur direkt në rrjetin elektrik, kështu që ka pamundësuar regjistrimin e saktë të energjisë elektrike të shpenzuar e të dëmtuarës KEDS-Distrikti Gjakovë i ka shkaktar dëm në vlerë prej 165.95 €, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar KEDS-Distrikti Gjakovë.

-me çka ka kryer vepër penale vjedhje të shërbimeve komunale nga neni 320 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata konform nenit 4,6,7,41,42,46,49, par.1 pika 1.1 ,50,51 par.4, 52 dhe 73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të njëjtin e:

G J Y K O N

Më dënim më gjobë në shumë prej 100 (njëqind) euro i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohor prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale. Nëse i akuzuari kryen vepër tjetër penale në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5 ditësh duke llogaritur 20 euro të gjobës në një ditë burgim.

-Si dhe me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **3 (tre)** muajve, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

E dëmtuara KEDS-it-Distrikti në Gjakovë, lidhur më kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil.

Obligohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t`ia paguajnë shumën prej 20 euro ndërsa shpenzime të procedurës penale nuk ka pasur.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të behet me detyrim.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1821/2017 të dt.22.12.2017, e ka akuzuar N. G., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar më dt.21.03.2018, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës, prokurori e shtetit Bajram Kryeziu, i akuzuari N. G., andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I pandehuri N. G., deklarohej i fajshëm, për të gjitha pikat e akuzës, më vjen keq për rastin i cili ka ndodhur, ky ka qenë rasti im i parë që kam ra ndesh më ligjin, i kam kushtet e vështira ekonomike, për të cilin jam penduar dhe i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm që të mos bije ndesh më ligjin.

Prokurori e shtetit jep mendimin se pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe meqenëse i akuzuari e pranoj fajësinë, më rastin e shqiptimit të dënimit gjykata t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, dhe i akuzuari të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-në tersi u vërtetua së i akuzuari N. G. në mes të datës së pavërtetuar e gjerë më dt.09.06.2017, në fsh. V. K. Malishevë, në shtëpinë e tij, më qëllim vetit apo tjetrit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm me qëllim vjedhje, pa njehsor elektrik përmes kabllor është lidhur direkt në rrjetin elektrik, kështu që ka pamundësuar regjistrimin e saktë të energjisë elektrike të shpenzuar e të dëmtuarës KEDS-Distrikti Gjakovë i ka shkaktar dëm në vlerë prej 165.95 €, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar KEDS-Distrikti Gjakovë.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat me lartë, ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke e vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPPK-së, të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale, të akuzuarit, pranimin e fajësisë, pendimin e tij, është i ati i 5 fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, premtimin së në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, sjellja e tij në shqyrtim, si dhe nuk është përsëritës i veprave penale, kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim së me dënimet me kusht, shumën prej 100 euro, si dhe dënimin me burg prej 3 muajve, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda afatit prej një 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 të KPPK-së, dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimin mbi udhëzimin në kontestin civil gjykata e mbështeti në nenin 463 par.1 dhe.2 të KPPK-së, ndërsa vendimin mbi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale gjykata e mbështeti në nenin 450 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË

P.nr.434/17, më dt.21.03.2018.

Sekretarja juridike
Behije Karaçica

G j y q t a r i
Lulzim Paçarizi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.